

L I G J
Nr. 8631, datë 3.7.2000

**PËR RATIFIKIMIN E “AMENDAMENTIT TË MARRËVESHJES DYPALËSHE “PËR
RISKEDULIMIN E DETYRIMEVE TË BORXHIT TË JASHTËM TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NDAJ KREDITORËVE HOLLANDEZË””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Amendamenti i marrëveshjes dypalëshe “Për riskedulimin e detyrimeve të borxhit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë ndaj kreditorëve Holandezë””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2688, datë 7.7.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

**TERMAT E REFERENCËS
LIDHUR ME KONSOLIDIMIN E BORXHIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

I – HYRJE

Përfaqësuesit e Qeverive të Gjermanisë, Austrisë, Francës, Italisë, Japonisë, Holandës dhe të Federatës Ruse, të quajtura më poshtë “vendet pjesëmarrëse kreditore” kanë vendosur t’i akordojnë Republikës së Shqipërisë një lehtësim të shërbimit të borxhit të jashtëm të këtij vendi, në formën e një diferencimi pagesash.

Përfaqësuesit e Qeverive të vendeve pjesëmarrëse kreditore janë njoftuar mbi masat e rëndësishme që janë marrë në fushat ekonomike dhe financiare në kuadrin e programit të rregullimit të zbatuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, mbështetur në marrëveshjen për Mbështetjen e Reformave Strukturore me Fondin Monetar Ndërkombëtar e miratuar nga Këshilli Administrativ i Fondit më 13 Maj 1998 dhe që mbulon periudhën deri më 12 Maj 2001. Kjo marrëveshje përmban angazhime të sakta në fushat ekonomike dhe financiare.

Përfaqësuesit e këtyre vende kanë theksuar rëndësinë që ata i kushtojnë përmbushjes së rregullt dhe të plotë të kësaj Marrëveshjeje dhe, në mënyrë të veçantë, rigjallërimit të sektorit prodhues dhe përmirësimit të drejtimit të financave shtetërore dhe të përdorimit të rezervave valutore.

Ata janë njohur me problemet shumë të rënda të bilancit të pagesave dhe me borxhin e madh të Republikës së Shqipërisë, si edhe me nivelin e ulët të të ardhurave për banor dhe janë të mendimit që të gjitha këto meritojnë një trajtim të veçantë të borxhit, duke pasur parasysh programin e rëndësishëm të rregullimit të theksuar më sipër.

II. REKOMANDIME LIDHUR ME TERMAT E REFERENCËS:

Duke marrë parasysh vështirësitë serioze të pagesave që has Republika e Shqipërisë, përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrëse kreditore ranë dakord t'u rekomandojnë Qeverive të tyre ose organizmave përkatës, një lehtësim të borxhit të Republikës së Shqipërisë me anë të një ndryshimi (riorganizimi), sipas termave të mëposhtme:

Përcaktimi i borxheve për të cilat bëhet fjalë

Borxhet për të cilat do të zbatohet ky riorganizim janë:

a) kreditë tregtare, që kanë pasur në fillim një afat të kredisë mbi një vit, të garantuara ose të siguruara nga Qeveritë ose organizmat përkatës të vendeve pjesëmarrëse kreditore, të akorduara Qeverisë së Republikës së Shqipërisë ose organizmave përkatës të saj, ose të garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose institucionet e saj përkatëse dhe që janë objekt i një kontrate të përfunduar përpara 30 shtatorit 1993;

b) huatë qeveritare ose të organizmave përkatëse të vendeve pjesëmarrëse kreditore, që kanë në fillim një zgjatje të kredisë mbi një vit, të akorduara Qeverisë së Republikës së Shqipërisë ose organizmave të saj përkatëse, ose të garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose nga institucionet e saj përkatëse, dhe që janë objekt i një kontrate të përfunduar përpara 30 Shtatorit 1993.

c) shlyerjet e principalit dhe të interesave që rezultojnë nga marrëveshjet e konsolidimit të përfunduara ose për t'u përfunduar në zbatim të Nenit I të Termave të Referencës së 15 dhjetorit 1993;

d) shlyerjet e principalit dhe të interesave që rezultojnë nga marrëveshjet e konsolidimit të përfunduara ose për t'u përfunduar në zbatim të Nenit II, paragrafet 1 dhe 2 të Termave të Referencës së 22 korrikut 1998;

e) huatë dhe kreditë, që kanë fillimisht një kohëzgjatje mbi një vit dhe që janë objekt i një kontrate ose i çdo forme tjetër marrëveshjeje financiare e përfunduar midis 30 shtatorit 1993 dhe 1 prillit 1999;

f) kreditë tregëtare që kanë fillimisht një kohëzgjatje më të vogël ose të barabartë me një vit, të përfunduara përpara 1 prillit 1999;

Në këtë riorganizim përfshihet shërbimi i borxhit, në kuptimin e borxheve të përshkruara më sipër në këto terma reference dhe i kryen nëpërmjet mekanizmave speciale të pagesës ose llogarive të tjera të jashtme. Vendet pjesëmarrëse ose kreditore do të ricaktojnë, do të rifinancojnë ose do të marrin masa të tjera të përshtatshme me qëllim që të sigurojnë që kjo kategori e borxheve të trajtohet sipas termave të krahasueshme me ato të zbatuara për borxhe të tjera që përfshihen në këto Terma Reference.

Kuptohet që shërbimi i borxhit për huatë dhe kreditë e përfshira në paragrafet 1.e) dhe 1.f) në asnjë rast nuk do të preket me një trajtim përfundimtar.

2) Kushtet e reja të shlyerjes

Lehtësimi i borxhit do të bëhet sipas mënyrës së mëposhtme:

a) 100% e shumave të principalit dhe të interesave (duke përfshirë edhe interes -vonesat) që duheshin paguar më 31 mars 1999 dhe që nuk janë paguar dhe 100% e shumave të principalit dhe interesave (duke përfshirë interes vonesat) që duhen paguar në periudhën ndërmjet 1 prillit 1999 dhe 30 qershorit 2000 (duke përfshirë edhe këtë datë) dhe që nuk janë paguar për kreditë dhe huatë e cituara në paragrafët 1.a), 1.b), 1.c), 1.d), 1.e) dhe 1.f) këtu më sipër, do të ricaktohen ose rifinancohen. Kthimi i shumave përkatëse nga ana e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, do të kryhet në 10 kështe të barabarta dhe të njëpasnjëshme gjashtëmujore, kësti i parë do të paguhet më 30 qershor 2001 dhe i fundit më 31 dhjetor 2005;

b) Përqindjet dhe kushtet e interesit për marrëveshjet e ricaktimit ose të rifinancimit që mbulohen nga paragrafi a) më sipër dhe nga paragrafi c) më poshtë, do të përcaktohen në baza dypalëshe ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë ose institucionit përkatës të secilit prej vendeve pjesëmarrëse kreditore, mbi bazën e përqindjes përkatëse të tregut. Përsa i përket Huave të Ndihmës Shtetërore për Zhvillim, përqindjet dhe kushtet e interesit do të jenë të paktën po aq favorizuese sa edhe përqindjet koncensionale që zbatohen aktualisht për këto hua.

Interes-vonesat janë interesa që zbatohen për periudhën midis datës së fiksuar në kontratë për pagesën e principalit dhe të interesave që duhen paguar dhe që nuk janë paguar dhe një datë që do të fiksohet në marrëveshjet dypalëshe që do të nënshkruhen në zbatim të këtyre Termave të Referencës.

c) 100% e interesave të parashikuara ndërmjet 1 Prillit 1999 dhe 30 Qershorit 2000 (duke përfshirë edhe këtë datë), për shumat e konsoliduara dhe të theksuara në paragrafin a) këtu më sipër, do të kapitalizohen me 30 Qershor 2000 dhe do të paguhet në 10 kështe të barabarta dhe të

njëpasnjëshme gjashtëmujore, i pari më 30 qershor 2001 dhe i fundit më 31 dhjetor 2005.

III. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

1. Me qëllim që të sigurojë një trajtim të barabartë të borxhit të saj kundrejt të gjithë kreditorëve publikë ose privatë, Qeveria e Republikës së Shqipërisë angazhohet të negociojë në afatet më të përshtatshme me të gjithë kreditorët e saj të jashtëm, marrëveshje të riadministrimit të borxhit me terma të krahasueshme me ato të parashikuara nga këto Terma Reference.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë angazhohet që të mos i akordojë asnjë kategori të kreditorëve të jashtëm dhe në mënyrë të veçantë vendeve kreditore që nuk marrin pjesë në këto Terma Reference, bankave tregtare dhe furnitorëve një trajtim më të favorshëm se ai i akorduar vendeve pjesëmarrëse kreditore dhe kreditë me kohëzgjatje dhe natyrë juridike të ngjashme.

Me qëllim që të krahasohen marrëveshjet e përfunduara ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë me kreditorët e saj që nuk janë pjesëmarrës në këto Terma Reference, nga njëra anë, dhe marrëveshjet e përfunduara me vendet pjesëmarrëse kreditore, nga ana tjetër, do të merren në konsideratë të gjitha elementet domethënëse, ndërmjet të cilave: rreziku real i vendeve kreditore që nuk marrin pjesë në këto Terma Reference; niveli i pagesave në para që janë kryer në favor të këtyre vendeve nga ana e Republikës së Shqipërisë në raport me peshën e tyre në borxhin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë; natyra dhe tiparet e çdo varianti të paraqitur, duke përfshirë edhe blerjen e borxhit, si edhe të gjitha karakteristikat e pretendimeve të ribiseduara dhe në mënyrë të veçantë termat e pagesës (kthimit të borxhit) të çfarëdo forme dhe në përgjithësi, lidhjet financiare midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe vendeve kreditore që nuk marrin pjesë në këto Terma Reference.

2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të njoftojë me shkrim Presidentin e Klubit të Parisit, jo më vonë se 31 mars 2000, mbi gjendjen e bisedimeve të saj dhe me përmbajtjen e marrëveshjeve dypalëshe që ajo ka arritur me kreditorët e tjerë. Përveç kësaj, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të njoftojë rregullisht me shkrim Presidentin e Klubit të Parisit për gjendjen e bisedimeve me kreditorët e tjerë dhe për pagesat e kryera në favor të tyre.

3. Dispozitat e këtyre Termave të Referencës nuk zbatohen për ato vende kreditore për të cilat shuma e përgjithshme e kësteve të principalit dhe interesit që duhen paguar gjatë periudhës së riorganizimit në kuptimin e borxheve të specifikuara në Nenin II, paragrafi 2, është më e vogël se 150,000 SDR.

Pagesat për këto vende duhen kryer më 30 Qershor 2001. Interesat e pashlyera për këto shuma do të llogariten dhe kapitalizohen më 30 Qershor 2000.

4. Vendet pjesëmarrëse kreditore kanë rënë dakord, që secili prej tyre do t'i japë, me kërkesën e çdo vendi tjetër pjesëmarrës kreditor një kopje të marrëveshjes së saj dypalëshe me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë në zbatim të këtyre Termave të Referencës. Qeveria e Republikës së Shqipërisë është në dijeni të kësaj dispozite.

5. Secili prej vendeve pjesëmarrëse kreditore pranon të njoftojë Presidentin e Klubit të Parisit për datën e nënshkrimit të marrëveshjes përkatëse dypalëshe, për përqindjet e interesit që janë zbatuar si dhe për shumat e borxhit që kanë të bëjnë me secilën prej marrëveshjeve. Qeveria e Republikës së Shqipërisë është në dijeni të kësaj dispozite.

6. Qeveria e Republikës së Shqipërisë angazhohet të paguajë të gjitha kështet që duhen paguar dhe që nuk janë paguar deri në datën e këtyre Termave të Referencës në lidhje me konsolidimin e huave, kredive ose të gjitha formave të tjera të rregullimit financiar të pagueshme me para, të akorduara ose të garantuara nga Qeveritë ose organizmat përkatës të vendeve pjesëmarrëse kreditore, dhe që nuk bëjnë pjesë në fushën e zbatimit të këtyre Termave të Referencës, dhe kjo sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe në çdo rast, jo më vonë se 31 Dhjetor 1999.

Për këto shuma do të zbatohen interes-vonesa.

IV. ZBATIMI

Mënyrat e ricaktimit ose të rifinancimit do të fiksohen në marrëveshjet dypalëshe që do të nënshkruhen nga qeveritë ose organizmat përkatës të secilit prej vendeve pjesëmarrëse kreditore me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë mbi bazën e parimeve të mëposhtme:

1) Qeveria ose institucionet përkatës të çdo vendi pjesëmarrës kreditor:

- Ose do të rifinancojë borxhet, duke vënë në dispozicion të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë financime të reja në përputhje me kështet ekzistuese të pagesës gjatë periudhës së konsolidimit dhe për përbindjet e treguara më lart. Këto financime do të kthehen (paguhen) nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në përputhje me kështet e treguara në Nenin II.2 më sipër;
 - Ose do të ricaktojë kështet përkatëse.
- 2) Të gjitha çështjet e tjera që kanë të bëjnë me ricaktimin ose rifinancimin do të fiksohen në marrëveshjet dypalëshe që Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe qeveritë ose organizmat përkatës të vendeve pjesëmarrëse kreditore do të përpiqen të përfundojnë në afate sa më të përshtatshme, dhe në çdo rast, përpara 31 marsit 2000.
- 3) Dispozitat e këtyre Termave të Referencës do të vazhdojnë të zbatohen me kusht që Qeveria e Republikës së Shqipërisë vazhdon të ketë një marrëveshje përkatëse me FMN-në dhe që ajo të ketë kryer në kohën e duhur pagesat e parashikuara nga këto Terma Reference.
- Për këtë qëllim, Qeveria e Republikës së Shqipërisë është dakord që FMN-ja të njoftojë me shkrim Presidentin e Klubit të Parisit mbi gjendjen e marrëdhënieve ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe FMN-së.
- 4) Përfaqësuesit e Qeverive të vendeve pjesëmarrëse kreditore dhe përfaqësuesit e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë kanë rënë dakord t'u rekomandojnë qeverive ose organizmave të tyre përkatëse që të fillojnë sa më shpejt bisedimet dypalëshe dhe t'i zhvillojnë ato mbi bazën e parimeve të theksuara më sipër.

ANEKS V

Rishikim i detyrimeve të riskeduluara

Datë 18.02.2000

Shteti: Shqipëri

Konsolidimi 202 ToR 201 Principal dhe Interes Monedha NLG

Data e Marrëveshjes Shumëpalëshe: 14.10.1999 Data e Marrëveshjes Dypalëshe:

Nga Konsolidimi (No)	Data e detyrimit	Prncipal	Interes Konsolid.	Gjithsej.
201 Vonesa afatshkurtra (30.09.93)	31.12.1999	248.928		248,928
	31.12.1999		29.227	29.227
	30.06.2000	298.711		298.711
	30.06.2000		20.349	20.349
Gjithsej Konsolidimi 201		547.639	49.576	597.215
GJITHSEJ:		547.639	49.576	597.215

Rishikimi i Detyrimeve të Riskeduluara

Data 18.02.2000

Shteti: Shqipëri

Konsolidimi 203 ToR 201, Interes-Vonesa 01.01.2000/Monedha NLG

Data e Marrëveshjes Shumëpalëshe: 14.10.1999 Data e Marrëveshjes Dypalëshe:

Nga Konsolidimi (No)	Data e detyrimit	Prncipal	Interes Konsolid.	Gjithsej.
202 Tor, Principal dhe Interes	30.06.2000		7.607	7.607
Gjithsej Konsolidimi 202			7.607	7.607
GJITHSEJ:			7.607	7.607

ANEKS VI

Rishikim i Pagesave të Konsoliduara

Data 18.02.2000

Shteti: Shqipëri

Konsolidimi 202 ToR 201, Principal dhe Interes / Monedha: NLG

Data e Marrëveshjes Shumëpalëshe: 14.10.1999 Data e Marrëveshjes Dypalëshe:

Data e Skedulimit	Pagesa %	Termtat Int%	Përshkrimi	Pagesa e skeduluar	Rikonsolidim i numri / shuma	Pagesa Vonesat
30.06.2000		5.50	INTERES	7.607	203	
31.12.2000		5.50	INTERES	16.511	7.607	
30.06.2001	10.00		PRINCIPAL	54.766		
	10.00		INT.KAPITALIZ.	4.958		
		5.50	INTERES	16.287		
31.12.2001	10.00		PRINCIPAL	54.766		
	10.00		INT.KAPITALIZ.	4.958		
		5.50	INTERES	14.903		
30.06.2002	10.00		PRINCIPAL	54.766		
	10.00		INT.KAPITALIZ.	4.958		
		5.50	INTERES	13.029		
31.12.2002	10.00		PRINCIPAL	54.766		
	10.00		INT.KAPITALIZ.	4.958		
		5.50	INTERES	11.592		
30.06.2003	10.00		PRINCIPAL	54.766		
	10.00		INT.KAPITALIZ.	4.958		
		5.50	INTERES	9.773		
31.12.2003	10.00		PRINCIPAL	54.766		
	10.00		INT.KAPITALIZ.	4.958		
		5.50	INTERES	8.280		
30.06.2004	10.00		PRINCIPAL	54.766		
	10.00		INT.KAPITALIZ.	4.958		
		5.50	INTERES	6.534		
31.12.2004	10.00		PRINCIPAL	54.766		
	10.00		INT.KAPITALIZ.	4.958		
		5.50	INTERES	4.953		
30.06.2005	10.00		PRINCIPAL	54.766		
	10.00		INT.KAPITALIZ.	4.958		
		5.50	INTERES	3.256		
31.12.2005	10.00		PRINCIPAL	54.745		
	10.00		INT.KAPITALIZ.	4.954		
		5.50	INTERES	1.657		
Gjithsej konsolidimi			PRINCIPAL	547.639		
			INT.KAPITALIZ.	49.576		
			INTERES	114.382	7.607	
			INTERES-VONESA			
			PAGESA TË TJERA			
			SHTESA-			

INTERESASH

Rishikimi i Pagesave të Konsoliduara

Data 18.02.2000

Shteti: Shqipëri

Konsolidimi 203 ToR, Interes vonesa 01.01.2000/30.06.2000 /Monedha NLG

Data e Marrëveshjes Shumëpalëshe: 14.10.1999 Data e Marrëveshjes Dypalëshe:

Data e Skedulimit	Pagesa %	Termat Int%	Përshkrimi	Pagesa e skeduluar	Rikonsolidimi numri / shuma	Pagesa Vonesat
31.12.2000		5.50	INTERES	211		
30.06.2001	10.00		INT.KAPITALIZ.	762		
		5.50	INTERES	207		
31.12.2001	10.00		INT.KAPITALIZ.	762		
		5.50	INTERES	189		
30.06.2000	10.00		INT.KAPITALIZ.	762		
		5.50	INTERES	166		
31.12.2002	10.00		INT.KAPITALIZ.	762		
		5.50	INTERES	148		
30.06.2003	10.00		INT.KAPITALIZ.	762		
		5.50	INTERES	126		
31.12.2003	10.00		INT.KAPITALIZ.	762		
		5.50	INTERES	106		
30.06.2004	10.00		INT.KAPITALIZ.	762		
		5.50	INTERES	81		
31.12.2004	10.00		INT.KAPITALIZ.	762		
		5.50	INTERES	63		
30.06.2005	10.00		INT.KAPITALIZ.	762		
		5.50	INTERES	41		
31.12.2005	10.00		INT.KAPITALIZ.	749		
		5.50	INTERES	19		
Gjithsej konsolidimi			PRINCIPAL			
			INT.KAPITALIZ.		7.607	
			INTERES		1.357	
			PRINCIPAL			
			INT.KAPITALIZ.			
			INTERES			
			INTERES-VONESA			
			PAGESA TË TJERA			
			SHTESA-			
			INTERESASH			